MR.FATMIR SEJDIU (PRISHTINE)
BAZA JURIDIKE POLITIKE E REPUBLIKES SE KOSOVES

Si një nga tetë njësitë federale të ish-Jugosllavisë, Kosova paraqet subjektin më specifik si në aspektin e kompaktësisë territoriale e të pozicionit gjeoekonomik, të përbërjes etnike dominante shqiptare[1] si edhe përkrah pozicionit të veçantë politik me një kontinuitet të pashkëputshëm të mëvetësisë politike.

Duke filluar nga këta elementë dhe duke pasur si qëllim të hedhim dritë mbi bazën juridike-politike të Republikës së Kosovës, si një realitet i ri i kohës, e në të njëjtën kohë si një variant minimum drejt zgjidhjes së çështjes shqiptare, mendojmë se është e nevojshme që shkurtimisht të përkujtohen disa faktorë, të cilët mbështetjen e tyre e kanë në të drejtën etnike historike, natyrore e njerëzore si dhe në të drejtën e mbështetur mbi parimin e njohur të vetëvendosjes, e cila përfshihet në të gjitha dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare, e para së gjithash në Kartën e OKB.

Pozicioni juridik politik i Kosovës gjatë fazave të mëhershme të historisë, i përshkruar me elementë të mëvetësisë së saj politike është i një vazhdimësie të pashkëputshme. Edhe pse mund të thuhet se ky subjektivitet, apo kjo mëvetësi politike, pas rënies së shtetit ilir-dardan gjatë etapave të ndryshme, nuk është i njëllojtë dhe se përmban papërputhshmëri dhe kundërshtim në relacionet ndërmjet popullatës autoktone ilire-shqiptare dhe vullnetit të saj politik, nga njëra anë, dhe me strukturimet shtetërore të imponuara nga pushtuesit, nga ana tjetër. Megjithatë, vërehet një rregullshmëri e tillë, me nuanca të posaçme në ndërtimin juridik-politik, në organizimin territorial e administrativ dhe në sferat e tjera të strukturimit shtetëror, gjë që edhe kështu shpreh pozicionin specifik të Kosovës gjatë fazave të ndryshme të historisë së saj.

Dardania, si njëra nga katër provincat e Ilirikut Jugor[2] me qendrat e rëndësishme Naisusin, Scupin dhe Ulpianën, përfshin territorin e Kosovës së sotme si pjesën qendrore dhe qendrën e rëndësishme administrative territoriale.

Një organizim territorial - administrativ i tillë si nevojë e pushteteve sunduese në Kosovë, për të realizuar interesat e tyre, do t'i përshtatet në të njëjtën kohë në masë të dukshme rrethanave ekzistuese, varësisht nga specifikat e territorit, e duke filluar në radhë të parë nga përbërja etnike.

Prania e etnosit shqiptar, si faktor autokton, banues i Kosovës dhe i viseve të tjera, do të jetë në të shumtën e rasteve i provuar në mënyra të ndryshme. Në kurorëzimet e mbretërve të huaj, p.sh. pas pushtimit të pjesës më të madhe të Dardanisë në shek.XII, XIII, dinastët serbë, siç bie fjala Stefan Urosh Millutini, do ta cilësojnë veten si "Urossius rex Rasie, Edioclie, Albanie, Bulgarie et totius Maritime de gulfo Andriano a mari usque ad flumen Danubi Magni" (Uroshi, mbret i Rashës, i Duklës, i Shqipërisë, i Bullgarisë dhe i të gjithë bregdetit nga gjiu i Adriatikut prej detit e deri te lumi i Danubit të Madh)[3].

Edhe pse në te vërtetë me një akt të tillë nënkuptohet dëshira për shprehjen e fuqisë shtetërore që kishin dinastët nemanjiçë, në të njëjtën kohë me këtë del në pah edhe pamundësia për të mos i përfillur territoret e pushtuara.

Forcimi i pushtetit serb me Stefan Dushanin në krye, i kurorëzuar si Car më 1346, i cili zgjeroi përsëri territorin duke marrë toka të reja, shprehu po me aq forcë egërsinë e tij në drejtim të shembjes dhe të shkatërrimit të vlerave etnike, kulturore e religjioze të popujve të tjerë në tokat e pushtuara. Kosova, e cila nga shekulli XIV do të quhet me këtë emër[4], po ashtu sikur edhe një pjesë e madhe e territorit shqiptar do të bëhet objekt i një qasjeje të tillë.

Stefan Dushani në kulmin e fuqisë së tij, atëherë kur do të nxjerrë Kodin e tij (1349), pjesën e parë, dhe (1354) pjesën e dytë, megjithatë në të do të inkorporojë dispozita të tilla, të cilat, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, shprehin prezencën e elementit shqiptar. Edhe pse qasja e tij në të shumtën e rasteve është kërcënuese (sikurse e gjejmë një gjë të tillë në kodet e kohës), ajo në një farë mënyre edhe e legjitimon prezencën e shqiptarëve, edhe e ilustron statusin e tyre. Në nenin 39 të Kodit të Dushanit (versioni i Strugës) gjerësisht në nenin 83 (versioni i Atosit) në kreun "O Vlasima i Arbanasima" (mbi vllehët dhe shqiptarët) parashihet: "Në fshatin në të cilin është ndalur (vendosur) Vllahu apo shqiptari, në atë fshat mos të të ndalet tjetri, i cili shkon më pas. Po qe se ai ndalet (vendoset) me dhunë, të paguaj potkën..."[5].

Periudha e pushtimit osman edhe pse kishte të njëjtën tendencë, si edhe pushtimet e mëhershme një strukturë shtetërore të atillë përmes së cilës në tërësi do të realizoheshin aspiratat e çdo pushtuesi tjetër, megjithatë "dielli perandorak" nuk do të arrijë që gjithmonë të rrezojë me shkëlqimin e vet. Sikurse në viset e tjera shqiptare, ashtu edhe në Kosovë, krah për krah pushtuesit osman si pushtues i dhunës dhe pushtet i huaj, do të funksionojë si edhe në etapat e mëhershme, një pushtet tjetër, paralel i respektueshëm. Kjo në të vërtetë paraqet vetorganizimin tradicional të shqiptarëve, i cili shprehet si në jetën e përditshme - në raportet juridike e ekonomike, ashtu edhe në raportet e tjera, si edhe në organizimin e kryengritjeve të vazhdueshme antiosmane.

Formimi i vilajetit të Kosovës, si njëri nga të katër vilajetet shqiptare të Arnavutllukut, sipas Ligjit mbi vilajetet të vitit 1864[6], edhe pse kohësisht bie në periodën kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare shton dhe zgjeron aktivitetin e saj, në veçanti në paracaktimin e kërkesave gjithëshqiptare, përkah kompetencat që iu dhanë vilajetit, praktikisht mund të thuhet se Kosova merr statusin e një shteti konfederal në kuadër të Perandorisë Osmane[7].

Një kapitull të posaçëm në historinë e luftës së shqiptarëve për mëvetësi të plotë juridike-politike paraqet Lidhja e Prizrenit dhe e gjithë faza e mëvonshme deri me Shpalljen e Pavarësisë e që fatkeqësisht do të materializohet vetëm në gjysmën e tokës shqiptare.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit (10 qershor 1878 - 1881) mund të kuptohet vetëm si një organizatë e rëndësishme politike gjithëshqiptare, e organizuar për të kundërshtuar idetë e Traktatit të Paqes së Shën-Stefanit e njëkohësisht ato të vendimeve të Kongresit të Berlinit, të cilat do të shkonin në dëm të çështjes shqiptare. Ajo paraqet në të njëjtën kohë edhe mekanizmin e organizuar shtetëror e juridik që i kishte të gjitha elementet e një shtetësie të mëvetshme mbarë shqiptare. Lidhja Shqiptare e Prizrenit formoi qeverinë e vet dhe organet e tjera të rëndësishme, me të cilat u bë gati

që edhe politikisht edhe ushtarakisht të priste vendimet e Kongresit të Berlinit[8].

Nga kjo periodë e gjer në vitin 1912, gjegjësisht gjer në momentet e Shpalljes së Pavarësisë, Kosova jo vetëm që nuk u gjend në kuadër të Serbisë së pranuar në Kongresin e Berlinit, edhe pse ajo u cungua në aspektin territorial, por si e tillë ajo u shndërrua në vatër të vërtetë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Pushtimi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare, pikërisht në vigjilje të Shpalljes së Pavarësisë, shënon etapën tjetër karakteristike që shprehet me padrejtësitë e mëdha të bëra ndaj shqiptarëve nga ana e Fuqive të Mëdha. Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër(dhjetor 1912, gusht 1913)[9] janë pasqyra më e mirë e qëndrimit të Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare.

Me këtë akt, jo vetëm u cenua rëndë e drejta për vetëvendosje e një populli, por njëkohësisht u shkelën parimet e mirënjohura qytetëruese e demokratike, të praktikuara në jetën politike dhe shtetërore të popujve të tjerë, e pikërisht tek ata që kishin rol të posaçëm dhe influencë në lëvizjet politike dhe ndërkombëtare të kohës [10].

Territori i Kosovës i inkorporuar kështu dhunshëm dhe jashtë vullnetit të popullit shumicë në kuadrin e një shteti (të Serbisë), në kufijtë e të cilit nuk ishte as me rastin e konstituimit të tij dhe as me rastin e njohjes së tij si shtet i pavarur në Kongresin e Berlinit[11].

E njëjta gjë do të vlente edhe për periudhën e mëvonshme, pas ripushtimit të Kosovës, respektivisht në kohën kur u bë konstituimi i shtetit të serbëve, të kroatëve dhe të sllovenëve (1 dhjetor 1918), kur Kosova po ashtu dhunshëm do të gjendet brenda shtetit jugosllav, i cili do të njihet në Konferencën e Versajës më 1919. Edhe me këtë rast Kosova nuk do të hyjë në të si pjesë e Serbisë. Për këtë nuk ekziston ndonjë dokument shtetëror apo ndërkombëtar që Kosova të jetë e njohur si pjesë e Serbisë.[12]

Eshtë e nevojshme të theksohet se në luftën që zhvillohej ndërmjet partive politike në Jugosllavi ndërmjet dy luftërave botërore, disa nga këto parti në programin e tyre politik njohën të drejtën për zgjidhjen e çështjes shqiptare, të mbështetur në parimin e vetëvendosjes. Kështu u shpreh në programin e vet konkret Kongresi III i PKJ, i mbajtur në Vjenë më 1925. [13]

Një ide e tillë do të përcillet edhe me organizimin e mëvonshëm partiak në prag të Luftës II Botërore (Konferenca V e vendit të PKJ) si edhe gjatë luftës, kur përveç mekanizmave partiake organizohen edhe mekanizmat shtetërorë, sikurse është shembulli i Shtabit Kryesor Ushtarak dhe i Komitetit Krahinor të Kosovës, njësoj siç ishin shtabet kryesore dhe komitetet krahinore të njësive të Federatës së ardhshme Jugosllave. Pra, edhe në këtë periudhë Kosova nuk do të jetë pjesë e Serbisë, por do të jetë e barabartë me të. Kjo më së miri dëshmohet me faktin se në "Kuvendet e mëdha antifashiste të çlirimit kombëtar të Serbisë (VASNOS) nuk ishin përfaqësuesit e Kosovës (sikurse nuk ishin as në mbledhjen e dytë të KAÇKJ, Jajcë 1943) e as të Vojvodinës, të cilët në atë kohë funksiononin si subjekte të pavarura".[14]

Nga aktet më të rëndësishme burimore, me të cilat argumentohet përpjekja e shqiptarëve të Kosovës për realizimin e interesave të tyre nacionale, mbështetur në parimin e vetëvendosjes, janë vendimet e marra në Konferencën I të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës, të mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 në Bujan.[15]

E mbështetur në rezultatet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Konferenca miratoi Rezolutën mbi vetëvendosjen. Në tekstin e Rezolutës, përveç të tjerave,

parashihet edhe një kapitull në të cilin më së miri ilustrohet qëndrimi unanim me mbështetje të fuqishme juridike dhe politike për zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve në Kosovë, duke u bazuar në të drejtën për vetëvendosje. Në tekstin e Rezolutës, përveç të tjerave, thuhet : "Kosova e Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueme në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë , ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë. Prandaj, e ndjejmë për detyrë me i tregue rrugën e drejtë që duhet me ndjekë populli shqiptar për me realizue aspiratat e veta. Rruga e vetme, pra që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipninë asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksuer e rrogtarëve të tij, sepse kjo asht e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garancija për këtë asht Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipnisë, me të cilën ngushtësisht asht e lidhun.Përveç këtyne për këtë garantojnë aleatët t'onë të mëdhenj Bashkimi Sovjetik, Anglija e Amerika (Karta e Atllantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)"[16].

Aplikimi i administrimit të dhunshëm ushtarak dhe vënia e Kosovës në gjendje shtetrrethimi, e përcjellur me plojë dhe gjenocid ndaj shqiptarëve sikur që do të ndodhë edhe në momentet e mëvonshme të historisë së Kosovës, e posaçërisht në kthesat apo udhëkryqet kur dëshirohej të reduktohej pozicioni i saj juridik politik, do të shërbejë si mbështetje kërcënuese për aktet që pasojnë.

Organizimi i të ashtuquajturit Kuvendi i Kosovës, i tubuar pa zgjedhje të lira dhe procedurë demokratike, dhe në kohë të shtetrrethimit, mori detyrën që të realizojë aspiratën e Serbisë për realizimin e aneksimit të Kosovës, të Serbisë federale (pika 6 e rendit të ditës së sesionit të parë, të mbajtur më 8 korrik 1925). Duke pasur në fakt shumicën e delegatëve serbë dhe malazezë, ky "Kuvend" miratoi me aklamacion "Projektin e Rezolutës për aneksimin e Kosovës me Serbinë federale"[17], madje pa u diskutuar fare. Qëllimi është i qartë.

Edhe pse një akt i tillë u realizua në kundërshtim me Rezolutën e Konferencës së Bujanit, megjithatë kësaj Rezolute s'ka se si të mos i jepet karakteri i një akti të mbështetur mbi parimin e deklarimit të lirë politik dhe të vetëvendosjes[18], edhe pse është e qartë se nuk kishte mundësi të tjera të inkorporimit, pa e keqpërdorur edhe këtë parim nga ana e kreut politik - shtetëror jugosllav dhe serb.

Shprehja e këtij parimi, gjegjësisht e drejta e vetëvendosjes, do të gjejë vend edhe në Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1946, në atë të vitit 1963 e posaçërisht në ndryshimet kushtetuese të vitit 1968 dhe në vetë Kushtetutën e vitit 1974.

Kërkesat e shtruara gjatë debatit kushtetues, lidhur me ndryshimet kushtetuese të organizuara gjatë muajit shtator të vitit 1968, ku rëndësi të posaçme i jepet parimit të vetëvendosjes[19], respektivisht konstituimit të Republikës së Kosovës, e cila, pavarësisht nga qasjet politike, si kërkesë u artikulua me gjithë masivitetin popullor në demonstratat e organizuara më 27 nëntor 1968, në të gjitha qytetet e Kosovës dhe jashtë saj[20]. Kjo kërkesë u shpreh me gjithë dimensionin e saj edhe në periudhën e mëvonshme, e sidomos me demonstratat e marsit dhe të prillit të vitit 1981 dhe në të gjitha vitet e tjera deri më sot, që mund të quhen ndryshe edhe si vite të shtetrrethimit të pandërprerë të Kosovës.

Në ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, e në veçanti me rastin e nxjerrjes së

Kushtetutës së RSFJ dhe të Kushtetutës së Kosovës, Kosova në kuptimin e plotë të fjalës, si në parimet themelore, ashtu edhe në pjesën normative, përcaktohet si njëra nga tetë njësitë federale të Jugosllavisë.

Qytetarët e Kosovës, si pjesëmarrës të barabartë në krijimin e ish-Jugosllavisë Federale, (parimi 1 , paragrafi 1 i Kushtetutës së RSFJ, të vitit 1974), të drejtat e tyre sovrane (sikur edhe njësitë e tjera federale) i kanë realizuar në njësinë e vet federale në pajtim me të drejtat e tyre kushtetuese të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës dhe në atë Federative (parimi 2, paragrafi 1 i Kushtetutës).

Lidhur me pozitën e Kosovës në Federatën Jugosllave sipas Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974, përveç asaj se ajo konsiderohet pjesë konstituive e kësaj Federate (neni 2 dhe 4) është me rëndësi të theksohen edhe këto fakte : Kosova merrte pjesë me përfaqësuesit e vet në përbërjen e organeve federative: Në Kryesinë e RSFJ (neni 321), në Kuvendin Federativ (neni 291 dhe 292), në Këshillin Ekzekutiv Federativ (neni 348), në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë (neni 381), në Gjykatën Federative të Jugosllavisë (neni 370) në Bankën Popullore të Jugosllavisë (neni 263), në përfaqësitë diplomatike të Jugosllavisë si edhe në të gjitha institucionet dhe veprimtaritë e tjera me interes të përgjithshëm të nivelit federal.

Dhoma e republikave dhe e krahinave të Kuvendit Federativ nuk mund të nxirrte ligje dhe akte të tjera të përgjithshme pa pëlqimin pa konsensus edhe të Kosovës /nenet 286, 292, 295, 296, 298, 304/ etj. Kushtetuta e RSFJ nuk mund të ndryshohej pa pëlqimin edhe të Kosovës /nenet 398 dhe 402/ të Kushtetutës së RSFJ.

Si njësi e veçantë konstituive e Federatës së Jugosllavisë, Kosova ka territorin dhe kufijtë e vet të përcaktuara, të cilët nuk mund të ndryshojnë pa pëlqimin e saj (neni 5 i Kushtetutës së RSFJ i vitit 1974).

Si njësitë e tjera federale, edhe Kosova kishte Kushtetutën e vet, që e hartoi më 1974. Përmes saj edhe në harmoni me Kushtetutën federative, përcaktoi të drejtat e saj dhe rregulloi të gjitha marrëdhëniet juridike shtetërore, duke filluar nga struktura e organeve të Kosovës e deri te veprimtaritë e tjera shtetërore. Kosova kishte organin e vet ligjdhënës. Kuvendin e Kosovës (nenet 300, 388 të Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974), Kryesinë e vet, e cila e përfaqëson atë në Jugosllavi dhe jashtë (neni 339-348), Këshillin Ekzekutiv, qeverinë (neni 349, 362), organet administrative gjyqësore dhe organet e tjera të pushtetit shtetëror (nenet 362-394 të Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974).

Duke pasur parasysh argumentet e mbështetura në normat e Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ, mund të thuhet se subjektiviteti i Kosovës, respektivisht autonomiteti i saj ishte i shprehur në bazë dhe në vëllim të njëjtë me subjektivitetin , respektivisht me autonomitetin e njësive të tjera federale të ish-Jugosllavisë. Kjo cilësi e Kosovës shprehet në aspektin e vetorganizimit, të legjislacionit, të pushtetit ekzekutiv, të pushtetit gjyqësor, të financave, në veprimtarinë shoqërore, në planifikim dhe në zhvillim, në politikën sociale, në marrëdhëniet ndërkombëtare, në mbrojtjen dhe në sigurinë shtetërore dhe publike, në mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, në sigurimin dhe në realizimin e barazisë nacionale etj.

Me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, shqiptarët nuk trajtohen pakicë kombëtare, por kombësi, ndërkaq, sipas nenit 245 të kësaj Kushtetute kombësitë janë të barabarta me kombet.

Në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, shpërbërje kjo që u konfirmua edhe

me vendimin e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, në Raportin e Komisionit të arbitrazhit mbi Jugosllavinë[21], proces ky i cili filloi me shembjen e autonomisë së Kosovës dhe të Vojvodinës si edhe me orientimin ekspansionist të Serbisë ndaj ish-njësive të tjera federale, duke u ngritur edhe në shkallë të luftës së përgjakshme, Kuvendi i Kosovës , më 2 korrik 199O miratoi Deklaratën Kushtetuese me të cilën shpallet pavarësia e Kosovës[22], akt ky që u mbështet në të drejtën për vetëvendosje të popullit shqiptar, si popull shumicë.

Miratimi i Kushtetutës së Kaçanikut, më 7 shtator 199O, paraqet gjithashtu aktin e pakontestueshëm, me të cilin Kuvendi i Kosovës artikuloi kërkesat e përgjithshme të popullit, kërkesa këto që u shprehën jo vetëm në mbështetje të Deklaratës Kushtetuese mbi pavarësinë, por njëkohësisht u intensifikuan edhe në periudhën e mëvonshme, pavarësisht nga kriza e rëndë, në të cilën gjendej Kosova, për shkak të shtetrrethimit. Duke analizuar pjesën hyrëse - preambulën e Kushtetutës së Kosovës [23], vërehet qartë mbështetja burimore , në të cilën inkorporohet jo vetëm pjesa që ka të bëjë me pozicionin e popullit shqiptar dhe të Kosovës në rregullat kushtetuese juridike të deritanishme, por edhe mbështetja në parimet e mirënjohura të demokracisë , të drejtësisë njerëzore, të barazisë dhe të së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje[24].

Mbështetje të posaçme, si akt politik, paraqet deklarata e subjekteve politike shqiptare, anëtare të Këshillit Koordinues të partive shqiptare në Jugosllavi. Kjo deklaratë politike, e miratuar më ll tetor 1991, përcakton disa nga variantet e zgjidhjes së çështjes shqiptare në Jugosllavi.

l.Nëse nuk ndryshojnë kufijtë e jashtëm e as ata të brendshëm të Jugosllavisë, duhet të ekzistojë Republika e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, me të drejtë bashkimi në lidhjen e shteteve sovrane në Jugosllavi. Pjesët e popullit shqiptar që mbesin të jetojnë në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi do të kenë statusin e popullit shtetformues dhe të gjitha të drejtat që dalin nga kjo. 2.Nëse kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë nuk ndryshojnë, por ndryshojnë kufijtë e brendshëm ndërmjet republikave, atëhere kërkesa është Republika Shqiptare në Jugosllavi, e ndërtuar mbi bazën e parimit etnik dhe të parimeve të tjera që vlejnë për serbët, për kroatët, për sllovenët dhe për popujt e tjerë të Jugosllavisë. 3.Nëse ndryshojnë kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë, atëhere populli shqiptar në Jugosllavi, nëpërmjet deklarimit të përgjithshëm, plebishiti do të vendosë për bashkimin e territoreve në të cilat jetojnë shqiptarët dhe kështu do të krijohet shteti integral shqiptar në Ballkan në kufijtë e tij etnikë.[25]

Ndryshimet e mëdha, të cilat kanë pasuar nga koha e miratimit të kësaj deklarate, e në veçanti shkatërrimi i Federatës Jugosllave de facto dhe konfirmimi i mosqenies së saj (shih raportin e Komisionit të Arbitrazhit (komisioni i Badinterit) të BE si dhe vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të OKB për moszënien e Jugosllavisë), *de jure*, po ashtu edhe pranimi i ish-njësive të tjera federale të ish-Jugosllavisë, domosdo hapin edhe shumë çështje. Këto ndikojnë jo vetëm në modifikimin e opcioneve politikę (nga pika l dhe 2), por bëjnë të kërkohen edhe opcione të tjera, sikur bie fjala edhe ai mbi Kosovën si shtet sovran dhe neutral, natyrisht si zgjedhje e minimumit të kërkesave për shtetin aktual.

Referendumi i organizuar më 26-29 shtator 1991 në të cilin populli i Kosovës u shpreh edhe njëherë për Kosovën e pavarur e sovrane[26], si edhe zgjedhjet e organizuara pluraliste më 24 maj të vitit 1992, në bazë të vendimit mbi shpalljen e zgjed-

hjeve të Kuvendit të Kosovës të datës 2 maj 1992[27], përbëjnë bazën e qëndrueshme juridike dhe politike për Republikën e Kosovës.

Eshtë e qartë se në planin ndërkombëtar, përveç njohjes dhe pranimit që i bëri Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës në tetor të vitit 1991, nuk ekziston pranimi tjetër i këtij realiteti juridik-politik. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se qenia e një shteti, krah për krah vështirësive që mund të ketë ai, sidomos në planin ndërkombëtar, është provë se ai ekziston si i tillë, pavarësisht nga njohja që mund t'i bëhet, si vlerë deklarative nga ana e shteteve të tjera.[28]

Eshtë me rëndësi të theksohet se në luftën politike që bëjnë shqiptarët e Kosovës në rrugën e tyre për pavarësi dhe jetësimin e plotë të Republikës së Kosovës, një përkrahje e posaçme janë Rezolutat e Parlamentit Evropian[29] si edhe ato të Kongresit Amerikan në veçanti në planin e të drejtave të njeriut dhe të të drejtave nacionale.

Siç është e njohur, Konferenca e Hagës mbi Jugosllavinë si dhe ajo e Londrës (që vazhdoi në Gjenevë) padrejtësisht nuk morën në konsideratë statusin e Kosovës si njëra nga konstituentët e federatës. Me gjithë rezultatet ende dekurajuese të Konferencës dhe të grupit të posaçëm për Kosovën, nga puna e saj vlen të përmendet dokumenti final, e sidomos pika 5 e parimeve themelore, ku vëmendje e posaçme i përkushtohet edhe çështjes së vetëvendosjes.

Nga sa u shtrua më lart, në vend të përfundimit mund të konstatohet:

1) Baza juridike - politike për Republikën e Kosovës si shtet i pavarur e sovran ekziston. Kjo bazë mbështetet në të drejtën natyrore njerëzore, në të drejtën historike dhe në të drejtën e popullit për vetëvendosje, e drejtë kjo që as nuk është e parashikuar, as nuk është e kompensuar dhe as që mund të tjetërsohet në kontinuitet tjetër etnik.

2) Kosova gjatë gjithë historisë së saj, në mënyrë të bashkëpritshme, ka disponuar me elementët e mëvetësisë juridike- politike, e sidomos është i theksueshëm pozicioni i saj juridik- politik pas Luftës së Dytë Botërore dhe sot.

3) Kosova i plotëson të gjitha kushtet formale juridike, esenciale, (me përjashtim të gjendjes së tanishme të okupimit).Territori i saj aktual përbën një tërësi të pashkëputshme gjeografike dhe etnike dhe është i destinuar me kushtetutë, dhe si territor i tillë prap mbetet i rrethuar me territor tjetër etnik shqiptar në gjithë përfshirjen (Natyrisht duhet vërejtur se kjo ka të bëjë vetëm me orientimin për opcionin Kosova si Republikë e pavarur dhe neutrale).

4) Kosova disponon, sikundër edhe gjithë territori me shtrirje etnike shqiptare, një begati natyrore (resurse) të pashtershme (plumb, ar, argjend, zing, hekur etj., si: Trepça, Lishica, Novo Bërda, Lipnik-Obliq, Fushë-Kosova, nikel - Gllogovci, magnezit - Karaçeva, dhe miniera të tjera).

5) Kosova ka një potencial njerëzor vital, (shumica mbi 90 për qind shqiptarë etnikë), të cilët si tërësi në përqindjen më të madhe të mundshme kanë shprehur vullnetin e tyre politik përmes referendumit duke u mbështetur në të drejtën për vetëvendosje[31], për Kosovën si Republikë të pavarur dhe sovrane.

6) Organet legjitime të Kosovës: Kryetari i Republikës, Kuvendi dhe qeveria me angazhimin e deritanishëm politik dhe diplomatik janë deklaruar për zgjidhje paqësore të çështjes shqiptare në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, kanë dhënë shembull *sui generis* për zgjidhjen e krizës në rajon.

7) Organet legjitime të Kosovës jo vetëm një herë kanë deklaruar se Republi-

ka e Kosovës merr gjithë përgjegjësinë mbi vete për respektimin e parimeve themelore demokratike e pluraliste, duke filluar nga Karta e OKB si dokumenti i përgjithshëm ndërkombëtar dhe se merr mbi vete të gjitha detyrimet që dalin nga Helsinki dhe Parisi (1990), si edhe të dokumenteve të tjera ndërkombëtare.

Së fundi mund të përkujtojmë edhe këtë: të gjitha arsyet e shprehura në deklaratën mbi Pavarësinë e SHBA (1776) janë arsye të sotme të popullit shqiptar dhe të Kosovës duke filluar nga robëria klasike dhe kolonizimi tipik e gjer te terrori i përditshëm policor e ushtarak që s'di të ndalet.

1 Sipas vlerësimeve më të vonshme, mbështetur në normën mesatare të shtimit të popullsisë, supozohet se më 31 mars 1991 Kosova ka pasur 2 053 348 banorë, nga të cilët 1 889 000 ishin shqiptarë respektivisht 91,9 për qind. Shih: Vlerësimi i popullsisë së Kosovës në vitin 1991 dhe strukturën nacionale të saj. Analizë e përgatitur në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës, 24 dhjetor 1992.

2 Shih gjerësisht: Z.Mirdita, ***Studimet dardane,*** Prishtinë, 1979; A.Stipçeviç, ***Ilirët, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit,*** Prishtinë, 1990. ***Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri,*** Maket, Tiranë, 1982, f.72; ***Troll etnik dhe jetësor i shqiptarëve, Memorandum,*** në : "Bujku", 12.4.1992.

3 Sipas Mr.F.Fehmiu, ***Republika e Kosovës është shprehje*** *Restituiin integrum e të drejtës natyrore njerëzore, e të drejtës etnike dhe historike të popullit për* ***vetëvendosje***, dorëshkrim, Prishtinë, 1992, f.9. Punimi është i botuar në gazetën "Bujku", Rilindja, dhjetor, 1992 - janar 1993.

4 Shih : ***Trolli etnik dhe jetësor i shqiptarëve***, në "Bujku, 12 prill 1992.

5 ***Zakonik Cara Stefana Dushana, Struski i Atonski rukopis,*** Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Beograd, 1975, f.105, gjegjësisht 183.

6 ***Trolli etnik dhe jetësor i shqiptarëve,*** në :"Bujku", 12 prill 1992.

7 ***Po aty.***

8 ***Historia e popullit shqiptar,*** vëll.II, Prishtinë, 1969, f.125.

9 ***Po aty,*** f.364 - 380.

10 Shih :"Declaration des Droits de l'homme et du Citoyen", 1789, Deklaratë e miratuar, më 26 gusht 1789, në Asamblenë Franceze, botuar në : "Temelji moderne demokratije", Beograd, 1989, f.134.

11 Akademik G.Zajmi : ***Çështja shqiptare dhe parimi demokratik i vetëvendosjes,*** në "Zëri", nr.1480, 20 shkurt 1993, Prishtinë, f.17.

12 Shih : ***Trolli etnik...***

13 F.Kajtazi, ***Autonomia e Kosovës - argumente,*** në : "Rilindja" 9 korrik 1990, Prishtinë.

14 Mr.F.Fehmiu, ***Aspekte të ndërtimit kushtetues të Federatës sonë,*** në :"Rilindja", 2 tetor 1988, f.7; Akademik G.Zajmi, në : ***art. i përm.,*** f.17.

15 ***Këshilli Populluer i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë 1943-1953.*** Materialet themelore nga sesionet, Prishtinë, 1955, f.7 - 16.

16 ***Po aty,*** f.10.

17 ***Po aty,*** f.46.

18 *Trolli etnik...*

19 Shih M.Mishoviq, ***Ko je trazio Republiku Kosovo 1946 - 1985,*** Beograd, 1987, f.146 - 168.

2O Shih : S.Novosella, ***Ugrozavanje nacionalnih i ljudskih prava Albanaca na Kosovu u razdoblju 1966 - 198O,*** në: "Kosovo- zrtva", Zagreb, 1991, f.69 - 72.

21 ***SFRJ prestala da postoji i ima vise naslednika*** (Dokument, Izvestaj arbitrazne Komisije EZ o Jugoslaviji), në: "Politika", 8 korrik 1992.

22 "Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës", nr.21, Prishtinë, 3 korrik 199O.

23 ***Kushtetuta e Republikës së Kosovës,*** bot.II i gazetës "Dielli", Zagreb, 199O, f.9.

24 ***Po aty.***

25 ***Deklaratë politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi,*** Prishtinë, tetor 1991, f.2.

26 ***Nga raporti i Komisionit qendror për referendum i Kuvendit të Republikës së Kosovës,*** i dt.7 tetor 1991 shihet se në referendum, nga numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë deklarimi 1 O51 357 dolën 914 8O2 qytetarë, respektivisht 87,1 për qind. Nga ky numër 93O 7O5 ose 99,8 për qind ishin "pro", ndërsa "kundër" ishin 164 qytetarë, fletëdeklarimet e tjera ishin të pavlefshme.

27 Nga raporti i Komisionit Republikan të zgjedhjeve, botuar nga qendra për informim e Lidhjes Demokratike të Kosovës shihet se në zgjedhjet e mbajtura më 24 maj 1992, nga 853 432 zgjedhës, sipas regjistrave zgjedhorë, në zgjedhje morën pjesë 762 257, respektivisht 89,32 për qind zgjedhës. Ndërsa, për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës në zgjedhje morën pjesë edhe votuesit nga Kosova që gjenden jashtë saj, kështu që nga listat e zgjedhësve shihet se numri i tyre ishte 1O5 3OO votues, nga i cili numër 867 557 votuan për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

28 E.Hasani, ***Suksedimi i shtetit jugosllav dhe instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Kosovës,*** (Kumtesë), e lexuar në Simpoziumin "Ballkani dhe çështja shqiptare" në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

29 Shih : ***Resolution on the situation in Kosovo in southern Yuogoslavia.*** Botuar në : "Journal officiel des Communautes europeennos, 28.1O.1991 si edhe rezolutat e tjera me të cilat dënohet shkelja e rëndë e të drejtave njerëzore dhe nacionale të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

3O Shih : ***Parimi 5 themelor i Konferencës së Londrës "osnovni principi",*** në: "Borba", 4 shtator 1992.

31 Shih nenin 1 pika 2 të Kartës së OKB.